

VENDIM
Nr. 519, datë 16.8.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDA PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2012,
TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve brenda programeve, në buxhetin e vitit 2012, të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, zëri “Shpenzime korente”, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i pakësohet fondi prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh;

b) Programit të sistemit të burgjeve, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i pakësohet fondi prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh;

c) Programit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për vitin 2012, i pakësohet fondi për shpenzime personeli, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

ç) Programit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare, për vitin 2012, i pakësohet fondi prej 600 000 (gjashtëqind mijë) lekësh, për shpenzime personeli;

d) Programit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, për vitin 2012, i shtohet fondi në masën 10 400 000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë për shpenzime personeli;

dh) Programit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, për vitin 2012, në shpenzimet e personelit, i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha